

VENDIM
Nr. 943, datë 18.11.2015

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA NË VENDIMIN NR. 1081, DATË 18.12.2013, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR KRIJIMIN E KOMISIONIT NDËRINSTITUCIONAL PËR BASHKËRENDIMIN E PUNËS NË ZBATIMIN E PROJEKTIT TË GAZSJELLËSIT TRANS ADRIATIC PIPELINE (TAP)”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 116/2013, “Për ratifikimin e marrëveshjes me qeverinë e vendit pritës, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, duke vepruar nëpërmjet Këshillit të Ministrave, dhe Trans Adriatik Pipeline AG, lidhur me projektin e Gazsjellësit Trans Adriatik (Projekti TAP), dhe të marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave, dhe Trans Adriatik Pipeline AG, në lidhje me projektin e Gazsjellësit Trans Adriatik (Projekti TAP)”, të ligjit nr. 104/2013, “Për ratifikimin e marrëveshjes, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, Republikës së Greqisë dhe Republikës së Italisë, për projektin për Gazsjellësin Trans Adriatik (projekti TAP)”, dhe të nenit 4, të ligjit nr. 9946, datë 30.6.2008, “Për sektorin e gazit natyror”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Energjisë dhe Industrisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 1081, datë 18.12.2013, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Kudo në projektvendim fjalët “sekretariat teknik” zëvendësohen me “grup teknik i ekspertëve”.
2. Fjalja e parë e pikës 7, riformulohet, si më poshtë vijon:
3. “Komisioni Ndërinstitucional për projektin TAP ndihmohet nga grupi teknik i ekspertëve, i cili është përgjegjës për detyrat operative në lidhje me zbatimin e projektit TAP dhe zhvillimin e tregut të gazit në Shqipëri. Grupi teknik i ekspertëve ka këto detyra kryesore:”.

Në fund të pikës 8 shtohet paragrafi, me këtë përmbajtje:

“Çdo anëtar i grupit teknik të ekspertëve, në varësi të ngarkesës, angazhohet deri në 3 (tri) ditë pune në javë, me qëllim përmbushjen e detyrave të caktuara. Titullarët e institucioneve, që dërgojnë anëtarë në grupin teknik të ekspertëve, marrin të gjitha masat e nevojshme për vënien në dispozicion të këtyre nëpunësve.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

KËRKESË
Nr. 5857, datë 20.11.2015

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës shpall kërkesën “Për shpronësimet për interes publik, të pasurive pronë private që preken nga “Ndërtimi i Impiantit të Trajtimit të Ujërave të Përdorura në Qytetin e Korçës” për llojin e pasurisë “truall”.

Subjekti kërkues i këtij objekti, është Ujësjiellës-Kanalizime, Korçë (UKKO) sh.a. Me anë të këtij publikimi në shtyp kërkohet të vëmë në dijeni personat, të cilët preken nga ky shpronësim. Vënia në dijeni, konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur, në bazë të vendimit nr. 138, datë 23.3.2000, të Këshillit të Ministrave, “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe përlllogaritjes së masës së shpërblimit për pasuritë pronë private që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik”, i ndryshuar, për pronarët sipas listës emërore bashkëlidhur.

Pronarët që kanë emrin në listën emërore dhe personat e tretë, brenda 15 ditëve nga plotësimi i këtij

[illegible]